ALBSIG INVEST SH.A.

SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

PASQYRAT FINANCIARE

30 Qershor 2026

(të paaudituara)

TABELA E PERMBAJTJES

Pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese

1. Pasqyra e Bilancit/Pozicionit Financiar
2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve
3. Pasqyra e Fluksit të Parave
4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
5. Shënimet shpjeguese
6. Pasqyra e raportit të kapitalit
7. Pasqyra e shpenzimeve fikse
8. Pasqyra e detajimit të tarifave
9. Pasqyra e strukturës së aktiveve, depozita dhe llogari rrjedhëse
10. Pasqyra e srukturës së aktiveve, titujt
11. Pasqyra e srukturës së aktiveve, obligacione qeveritare qendrore dhe vendore
12. Pasqyra e srukturës së aktiveve, obligacione të shoqërive

Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë së administrimit	nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Numri i regjistrimit në QKR	L92208025J
Numri për raportimin	2
Adresa	"Downtown One", Bulevardi "Bajram Curri", HQ, Kati 16, 1010, Tiranë, Shqipëri.
Telefon dhe fax	+35542254764
E-mail:	info@albsiginvest.al
Faqe Web	www.albsiginvest.al
Data e licencimit	22.11.2019
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Irfan Lami (Kryetar) Dritan Kastrati (Anëtar) Elvis Beqiri (Anëtar) Elton Korbi (Anëtar) Admir Ramadani (Anëtar)
Pesë aksionarët më të mëdhenj (emri, mbiemri, adresa ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	Albsig Jetë Sh.a (100%)
Numri i punonjësve	6
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	RSM ALBANIA
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria administruese	Banka Tirana Sh.a Banka Kombëtare Tregtare Sh.a
Numrat e llogarisë	Banka Tirana Sh.a AL86206110040000100321044100 AL59206110040000100321044101 AL32206110040000100321044102 Banka Kombëtare Tregtare Sh.a AL3520511014005288CLPRCFEURM AL7420511014005288CLPRCLALLB

I. Pasqyra e Bilancit
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për datën: 30 qershor 2026

AKTIVI	Lekë 31/12/2025	Lekë 30/06/2026
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)	**30,734,688.07**	**30,564,210.53**
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)	-	-
1. Toka dhe Ndërtesa	-	-
2. Të tjera aktive afatgjata materiale	-	-
II. Aktive jo-materiale	734,688.07	564,210.53
III. Aktive financiare (1+2+3+4)	30,000,000.00	30,000,000.00
1. Depozita bankare	-	-
2. Investime financiare të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-
3. Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)	30,000,000.00	30,000,000.00
4. Të tjera aktive financiare afatgjata	-	-
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto	-	-
B. Aktivi tatimor i shtyrë		
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI)	**10,721,047.17**	**16,955,415.99**
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera		
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)	2,635,286.80	3,606,829.94
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve	2,635,286.80	3,606,829.94
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim	-	-
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera	-	-
4. Të tjera llogari të arkëtueshme	-	-
III. Aktive financiare (1+2+3+4)	-	-
1. Depozita bankare	-	-
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-
3. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)		-
4. Kuota në fonde investimi	-	-
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)	6,832,597.63	11,268,706.65
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	6,832,597.63	11,268,706.65
2. Mjete monetare në arkë	-	-
V. Shpenzime të parapaguara	1,253,162.74	2,079,879.40
VI. Të ardhura të llogaritura	-	-
D. Aktive (A+B+C)	**41,455,735.24**	**47,519,626.52**

PASIVI	Lekë 31/12/2025	Lekë 30-Jun-26
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)	**38,787,628.46**	**44,627,935.10**
I. Kapitali i nënshkruar	69,000,000.00	69,000,000.00
II. Rezerva të kapitalit	-	-
III. Rezerva e rivlerësimit	-	-
IV. Rezerva të tjera	-	-
V. Fitime / humbje të mbartura	- 35,487,943.00	- 30,212,371.54
VI. Fitimi / humbja neto për periudhën	5,275,571.46	5,840,306.64
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)	-	-
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve	-	-
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi	-	-
III. Detyrime të tjera afatgjata	-	-
C. Detyrim tatimor i shtyrë	-	-
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe	-	-
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)	**2,668,106.78**	**2,891,691.42**
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve	-	-
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi	-	-
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme	2,668,106.78	2,891,691.42
IV. Shpenzime të shtyra	-	-
V. Të ardhura të marra në avancë	-	-
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)	**41,455,735.24**	**47,519,626.52**

Check - -

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

	Lekë	Lekë
	30/06/2025	30-Jun-26
I. Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)	**13,279,310.56**	**17,658,616.06**
1. Tarifa të administrimit	11,438,573.32	14,738,599.39
2. Tarifa të largimit nga fondi	1,840,737.24	2,920,016.67
3. Tarifa të tjera	-	-
II. Shpenzime nga administrimi (1+2+3+4)	**827,862.85**	**915,351.34**
1. Shpenzime të transaksioneve	8,846.00	3,000.00
2. Shpenzime të marketingut	-	-
3. Shpenzime të shitjes me agjent	9,397.61	31,634.02
4. Shpenzime të tjera të administrimit të fondit	809,619.24	880,717.32
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit/investimeve (+/-) (I - II)	**12,451,447.71**	**16,743,264.72**
IV. Të ardhura të tjera	-	-
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)	**9,751,916.02**	**11,661,881.69**
1. Shpenzime për materiale	-	-
2. Shpenzime për personelin	8,081,882.00	9,952,716.80
3. Amortizim i aktiveve materiale afatgjata / jo materiale afatgjata	162,880.02	152,067.52
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afatshkurtra	-	-
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe	-	-
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë	1,507,154.00	1,557,097.37
VI. Të ardhura financiare	**822,957.86**	**810,884.45**
VII. Shpenzime financiare	**59,309.51**	**51,960.84**
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)	**3,463,180.04**	**5,840,306.64**
IX. Tatimi mbi fitimin	-	-
X. Fitim / Humbja neto për periudhën (VIII-IX)	**3,463,180.04**	**5,840,306.64**

3. Pasqyra e Fluksit të Parave
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

	Lekë	Lekë
	31/12/2025	**30-Jun-26**
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese	2,668,106.78	2,891,691.42
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese	1,987,850.81	2,644,089.93
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)	**680,255.97**	**247,601.49**
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese	-	-
e. Pagesa për veprimtarinë investuese	30,000,000.00	30,000,000.00
f. Flukse monetar neto nga veprimtaria investuese (d - e)	**- 30,000,000.00**	**- 30,000,000.00**
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese	- 2,635,286.80	- 3,606,829.94
h. Pagesa për veprimtarinë financuese	- 38,787,628.46	- 44,627,935.10
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)	**36,152,341.66**	**41,021,105.16**
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (c+f+i)	6,832,597.63	11,268,706.65
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël	-	-
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)	**6,832,597.63**	**11,268,706.65**

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
	31-Mar-26	**Rritje**	**Zbritje**	**30-Jun-26**
I. Kapitali i nënshkruar	69,000,000.00	-	-	69,000,000.00
II. Prime për aksione të emetuara	-	-	-	-
III. Rezerva e rivlerësimit	-	-	-	-
IV. Rezerva të tjera	-	-	-	-
V. Fitime (humbje) të mbartura	- 30,212,371.54	-	-	- 30,212,371.54
VI. Fitimi (humbja) e periudhës ushtrimore	-	5,840,306.64	-	5,840,306.64
VII. Pagesat e dividendit	-	-	-	-
VIII. Ndryshime në politikat kontabël dhe korrigjime	-	-	-	-
IX: Ndryshime të tjera në kapital	-	-	-	-
TOTALI I KAPITALIT (I+II+III+IV+V+VI+VII+VIII+IX)	**38,787,628.46**	**5,840,306.64**	**-**	**44,627,935.10**

1. Përshkrim i përgjithshëm

Albsig Invest sh.a., është Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, (tani e tutje do i referohemi si "Shoqëria Administruese" ose si "Shoqëria") e themeluar në tetor të vitit 2019, dhe e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Fondi i Investimit Albsig Standard u krijua në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009, zëvendësuar me Ligjin nr. 56/2020 datë 30 prill 2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji") dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 255, datë 30 dhjetor 2019. Fondi i Investimit u krijua nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribuues mbajtës të kuotave. Fondi është një fond investimesh që investon në tituj të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Fondi i Pensionit Privat Albsig (tani e tutje do i referohemi si "Fondi i Pensionit Albsig") u krijua ne përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023, "Për Fondet e Pensionet Privat" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji"), dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019. Fondi i Pensionit u krijua nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribuues mbajtës të kuotave. Fondi investon në tituj të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Banka e Tiranës sh.a është banka depozitare e Fondit të Investimit Albsig Standard dhe e Fondit të Pensionit Albsig, e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit të Investimit dhe Fondit të Pensionit, në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

Fondi i Pensionit Privat Smart Pension (tani e tutje do i referohemi si "Fondi i Pensionit Smart Pension") u krijua në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023, "Për Fondet e Pensionet Privat" (tani e tutje do i referohemi si "Ligji") dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), me vendimin numër 96, datë 28 prill 2022. Fondi i Pensionit u krijua nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribuues mbajtës të kuotave. Fondi investon në tituj të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Banka Kombëtare Tregtare është banka depozitare e Fondit të Pensionit Smart Pension, e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit të Investimit dhe Fondit të Pensionit, në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë Administruese dhe e Fondit është Bulevardi "Bajram Curri", Albsig HQ, Kati 16, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë, te cilat maten në vlerën e drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes.

c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën shqiptare "Lek" që është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveç se kur është shprehur ndryshe. Monedha funksionale është monedha e ambientit primar ekonomik në të cilin Shoqëria vepron. Investimet dhe veprimet e Shoqërisë kryhen në Lek. Për rrjedhojë, Këshilli i Administrimit ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale të Shoqërisë.

d) Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, detyrimeve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

e) Gjykimet kontabël dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, kërkon qe drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime qe ndikojnë ne aplikimin e politikave kontabël dhe ne vlerën e mbartur te aktiveve dhe detyrimeve, si edhe te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga ato te vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen ne mënyrë te vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen ne periudhën kur këto vlerësime rishikohen dhe gjithashtu ne periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. Politikat kontabël të rëndësishme

a) Standarde të reja

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 janar 2025 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë.

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

Standardet e reja te zbatueshme prej 1 janar 2025

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)

Standarde dhe interpretime të reja, ende të pa adoptuara

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet jo- monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut. Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përveç instrumenteve financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentet financiare në VDFH. Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqiptar për një njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
EURO	94.14	96.77
USD	82.64	82.46

c) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

i. Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria fillimisht njeh në mënyrë të rregullt, transaksionet me aktivet financiare dhe detyrimet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes ("VDFH") në datën e tregtimit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e instrumentit. Aktivet e tjera financiare dhe detyrimet financiare njihen në datën në të cilën ato krijohen.

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar matet në fillim me vlerën e drejtë plus, kostot e transaksionit në rastin e elementëve të përcaktuar jo me VDFH që i ngarkohen drejtpërdrejte blerjes ose emetimit të tij.

ii. Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Klasifikimi i aktiveve financiare
Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse përmbush njëkohësisht dy kushtet si më poshtë si edhe nuk është i destinuar si me VDFH:

- mbahet në një model biznesi i cili ka për qëllim të mbajë aktivet për të mbledhur flukset e parasë; dhe
- rrjedha e parasë, lind në data të përcaktuara, sipas kushteve kontraktuale, të cilat janë, vetëm pagesa principali dhe interesit (VPPI).

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit maten me VDFH.

d) Vlerësimi i modelit të biznesit

Në gjykimin e tij mbi vlerësimin e objektivave të modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv, Shoqëria merr parasysh të gjithë informacionin relevant mbi mënyrën se si biznesi po administrohet duke përfshirë:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit;
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e kaluara.

Shoqëria ka përcaktuar dy modele biznesi.

Modeli i biznesit mbajtje deri në mbledhje: ky model përfshin paranë dhe ekuivalentet e saj dhe të arkëtueshme. Këto aktive financiare mbahen në mënyrë që të mblidhen flukset kontraktuale të parasë. *Model tjetër biznesi:* kjo përfshin letrat me vlerë të qeverisë shqiptare dhe bonot e thesarit. Këto aktive financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, mbi bazën e vlerës së drejtë, meqenëse shitje të shpeshta të tyre ndodhin në treg.

e) Riklasifikimet

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e tij të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Në këtë rast të gjithë aktivet financiare që ndikohen, do të riklasifikohen në datën e parë në periudhën e parë raportuese që vijon ndryshimin e modelit të biznesit.

f) Matja e mëpasshme e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Aktivet financiare me VDFH
Këto aktive financiare maten më pas me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet neto, duke përfshire të ardhura ose shpenzime nga interesi, ose kurset e këmbimit, njihen në fitim humbje, në të ardhura neto nga instrumentet financiare në VDFH, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar
Këto aktive maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi njihen në të ardhura nga interesi sipas metodës së interesit efektiv, fitim humbjet nga kurset e këmbimit njihen në fitim humbje neto nga kurset e këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje në njohjen fillestare gjithashtu njihet në fitim humbje. Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe të arkëtueshme përfshihen në këtë kategori.

Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitim ose humbjet
Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me kosto të amortizuar ose në VDFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDFH nëse ai klasifikohet si i mbajtur për tregtim, nëse ai është një derivativ ose nëse është i destinuar si i tillë në njohjen fillestare. Detyrimet financiare në VDFH maten me vlerën e drejtë dhe fitim humbjet neto, duke përfshire edhe ndonjë interes, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrime të tjera financiare maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet nga interesat dhe fitim ose humbjet nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga ç'regjistrimi njihet po ashtu në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

Detyrimet financiare me VDFH
Këto janë instrumente financiarë të mbajtur për tregtim.

Detyrimet financiare me kosto të amortizuar
Këto janë detyrimet me palë të treta dhe detyrime të tjera.

i. Matja e vlerës së drejtë
'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes

në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë.
Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti financiar duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyron rëndësinë e përdorimit te faktorëve në këto matje:

- Niveli 1: Faktorë që janë të kuotuar me çmime tregu në tregje aktive të instrumenteve identike
- Niveli 2: Faktorë të tjerë nga ato të kuotuar me çmime tregu sipas Nivelit 1, dhe që janë të vëzhgueshem ose drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve) ose jo në mënyrë të drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve të përcaktuara).
- Niveli 3: Faktorë që janë të pavëzhgueshëm. Në këtë kategori përfshihen të gjithë instrumentet financiarë për te cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

Instrumentet financiare jo me vlerë të drejtë
Instrumentet financiare që nuk maten me VDFH përfshijnë:

- Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe detyrime të tjera. Këto janë aktive financiare dhe detyrime financiare afatshkurtra, vlera kontabël e të cilave është afërsisht e njëjtë me vlerën e drejtë, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër si edhe cilësinë e lartë të kredisë së tyre.

iv. Matja e vlerës se amortizuar

"Kostoja e amortizuar" e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare pasi janë zbritur ripagesat e principalit, ose amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim, dhe për aktivet financiare të rregulluar për ndonjë zhvlerësim.

v. Zhvlerësimi

Shoqëria njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK") për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar. Për te përcaktuar nëse rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të rëndësishme që prej njohjes fillestare të tij, dhe kur vlerëson HPK, Shoqëria merr parasysh informacionet mbështetëse dhe të arsyeshme dhe që janë relevant dhe të gatshme pa shume kosto dhe pune shtesë. Kjo përfshin analizim të informacionit cilësor dhe sasior, duke u bazuar në historikun dhe eksperiencën e Shoqërisë si edhe duke përfshirë informacione të cilat i përkasin të

ardhmes. Shoqëria supozon se rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyre të rëndësishme në rast se ai shfaqet më shumë se 30 dite në vonesë.

Shoqëria konsideron si aktive financiare me rrezik të ulët në rastet kur rreziku i kredisë të kundërpartisë është i listuar si BBB+ nga agjenci të mirënjohura të vlerësimit si Standard and Poor's, ose kur aktivet financiare lëshohen nga Qeveria Shqiptare ose nga Banka e Shqipërisë.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 30 qershor 2026.

vi. Ç'regjistrimi

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar kanë mbaruar, ose kur Shoqëria transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë në një transaksion në të cilin në mënyre të qenësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar ose në të cilin Shoqëria as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia dhe nuk ushtron kontroll mbi aktivin financiar.

Në njohje të një aktivi financiar, ndryshimi midis vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës së dhëne njihet në pasqyrën e fitim humbjes.

a. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë mjete monetare në llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj nga data e mbajtjes të cilat mund të jenë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme në vlerën e tregut dhe që përdoren nga Shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

b. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhura dhe shpenzime nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi efektiv llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skonton flukset e ardhshme të pagueshme ose të arkëtueshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në:

- vlerën bruto të aktivit financiar; ose
- vlerën me kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, metoda e interesit efektiv aplikohet mbi vlerën bruto të aktivit (në rast se aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit financiar.

c. Aktive afatgjata jomateriale

Program kompjuterik

Licensat për programet kompjuterike të blera kapitalizohen mbi bazën e shpenzimit të bërë për të blerë dhe vënë në përdorim. Markat dhe listat e klientëve të blera gjatë kombinimeve të bizneseve e që kualifikohen për t'u njohur më vete njihen si aktive afatgjata jomateriale me vlerë të drejtë. Norma

vjetore e amortizimit duke u bazuar në jetën e dobishme të vlerësuar për programet kompjuterike është 25%.

d. E drejta për të përdorur aktive afatgjata materiale

Qiratë e klasifikuara si qira operative bazuar në SNK 17

E drejta për të përdorur aktivin janë njohur me:

- vlerën e tyre të mbetur sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit, të skontuara me normen e brendshme të borxhit të Shoqërisë në datën e aplikimit për herë të parë: Shoqëria aplikoi këtë metodë për aktivet me vlerë më të madhe;

Shoqëria përdori disa përjashtime praktike gjatë aplikimit të SNRF 16 tek qiratë të cilat më parë ishin klasifikuar si qira operative sipas SKN 17. Në veçanti Shoqëria përdor këto përjashtime si më poshtë:

- nuk njohu të drejtën për të përdorur aktivin dhe detyrimin për qiranë për ato qira të cilat kishin maturitet më të vogël se 12 muaj që nga data e aplikimit;
- nuk njohu të drejtën për të përdorur aktivin dhe detyrimin për qiranë për ato qira të cilat kishin vlerë të vogël (p.sh. ato kontrata me vlerë më të vogël se 5 mijë Euro ose ekuivalenti i tyre në Lek).

e. Qiratë afatshkurtra dhe qiratë për aktive me vlerë të ulët

Shoqëria ka përzgjedhur të mos njohë të drejtën e përdorimit të asetit për qiratë për të cilët aktivi bazë është me vlerë të ulët dhe qiratë afatshkurtra. Shoqëria i njeh shpenzimet e lidhura me këto qira si shpenzime në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

f. Kapitali i shoqërisë

Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga paratë e kontribuara nga themeluesit e Shoqërisë. Kapitali i Shoqërisë mbahet me vlerën ekuivalente në Lek të kontributit të marrë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e kembimit të datës së transaksionit. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale të tij.

g. Kostot e huamarrjes

Shpenzimet e huammarjes që janë të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi të kualifikuar, të cilët janë aktive që kërkojnë një periudhë kohe të konsiderueshme për tu bërë gati për qellimin e përdorimit të tyre, i shtohen vlerës së këtyre aktiveve, për aq kohë sa nevojitet që këto aktive të jenë gati për përdorimin e parashikuar apo për tu shitur. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në të ardhura dhe shpenzime në periudhën kur ndodhin.

h. Përfitimet e punonjësve

Në rrjedhën normale të biznesit Shoqëria, kryen pagesa me emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar në sigurime shoqerore dhe shëndetësore të detyrueshmesipas legjislacionit lokal. Kostot e ndodhura nga ana e shoqërisë janë ngarkuar në pasqyren e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

i. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative njihen mbi bazën e kontabilitetit me të drejta të konstatuara kur ato ndodhin.

j. Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyrë

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin njihet në të ardhura dhe shpenzime përveç se kur ai i referohet zërave të njohura direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritur i pagueshëm mbi fitimin e pagueshëm të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara apo të miratuara në masë substanciale në datën e bilancit, dhe ndonjë rregullim të tatim fitimit të pagueshëm lidhur me vitin e mëparshëm. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% mbi fitimin e tatueshëm.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke krijuar provigjon për diferencat e përkohshme midis bazës tatimore dhe vlerave të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi apo që do të hyjë më vonë në fuqi përgjatë periudhës së rimarrjes.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të vlefshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen në masën qe përfitimet tatimore në lidhje me to janë të mundshme të realizohen.

k. Provigjionet

Provigjonet njihen atëhere kur: Shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara; ka shumë mundësi që një reduktim burimesh do të jetë i nevojshëm për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të vlerësohet me besueshmëri.

l. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura përfshijnë aksionerët dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ato kontrollojnë, te cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e Shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të tretë të mundshme vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

m. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguesekur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

n. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit të cilat vënë në dispozicion informacion shtesë mbi pozicionin e Shoqërisë në datën e pasqyrave të pozicionit financiar (ngjarje rregulluese), reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit të cilat nuk janë ngjarje rregulluese, paraqiten në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4. Gjykimet kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë të cilat paraqiten në shënimin 3, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tjera. Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndyshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen rregullisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet, nëse rishikimi ndikon vetëm në periudhën që rishikimohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse rishikimi ndikon në periudhen aktuale dhe në atë të ardhshme.

Pasiguri në gjykim

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvleresimi njihet në masën që vlera kontabel e aktivit e tejkalon shumen e tij të rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset monetare nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë të përshtatshme të interesit kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në çdo datë të pasqyrës të pozicionit financiar. Drejtimi gjykon që jeta e përcaktuar e dobishme të aktiveve përfaqson dobinë e pritshme të aktiveve. Vlerat e mbartura të këtyre aktiveve janë analizuar në shënimet 7 dhe 8. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të daljeve jashtë përdorimit nga ndryshimet teknologjike.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes së këtyre testimeve shoqëria merr parasysh pagesat e rregullta të bera, pra debitorin, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arkëtueshmërinë e pagesave nga instrumentet financiare dhe një numer kriteresh të tjera të përdorura për këtë vlerësim.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare: në përcaktimin e inputeve të modelit HPK (humbjes së pritshme të kredisë) duke përfshirë informacione të ardhshme.

5. Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj maten me koston e amortizuar në pasqyrat financiare dhe përbëhen si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Llogari rrjedhëse në Bankën Tirana (Lekë)	10,302,768.33	6,002,907.89
Llogari rrjedhëse në Bankën Tirana (Euro)	12,144.21	21794.71
Llogari rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare (Lekë)	953,794.11	807,895.03
Totali	**11,268,706.65**	**6,832,597.63**

Vlera prej 12,144.21 lekë përfaqëson ekuivalentin e 129.001 euro, e konvertuar me kursin 94.14.

6. Tarifa administruese e arkëtueshme

Të arkëtueshme nga Fondet është shuma për t'u marrë nga Fondi i Investimit dhe Fondet e Pensionit më 30 qershor 2026 dhe përbëhen si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Fondi i Pensionit "Albsig"	2,165,987.37	1,950,644.16
Fondi i Investimit "Albsig Standard"	252,260.34	248,968.64
Fondi i Pensionit "Smart Pension"	191,497.97	137,259.38
Të arkëtueshme nga tarifa e largimit Fondi "Albsig Pension"	997,084.26	297,592.79
Të arkëtueshme nga tarifa e largimit Fondi "Smart Pension"	-	821.83
Totali	**3,606,829.94**	**2,635,286.8**

7. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto

	Software	Totali
Kostoja		
Gjendja më 31 dhjetor 2025	**734,688.07**	**734,688.07**
Shtesa	-	-
Amortizimi për periudhën	**81,213.76**	**81,213.76**
Gjendja më 31 mars 2026	**653,474.31**	**653,474.31**
Shtesa	-	-
Amortizimi për periudhën	**89,263.78**	**89,263.78**
Gjendja më 30 qershor 2026	**564,210.53**	**564,210.53**

8. Kapitali

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Kapitali i nënshkruar	69,000,000	69,000,000
Prime për aksione të emetuara	-	-
Rezerva e rivlerësimit	-	-
Rezerva të tjera	-	-
Fitime (humbje) të mbartura	(30,212,371.54)	(35,487,943)
Fitimi (humbja) e periudhës financiare	5,840,306.64	5,275,571.46
TOTALI	**44,627,935.1**	**38,787,628.46**

9. Të ardhura nga tarifa administruese

	30 qershor 2026	31 qershor 2025
Tarifa nga Fondi i Pensionit "Albsig"	12,213,946.74	9,432,786.27
Tarifa nga Fondi i Investimit "Albsig Standard"	1,530,846.16	1,394,289.00
Tarifa nga Fondi i Pensionit "Smart Pension"	993,806.49	611,498.05
Tarifa të largimit nga Fondi "Albsig"	2,794,447.84	1,793,800.19
Tarifa të largimit nga Fondi "Smart Pension"	125,568.83	44,541.42
Tarifa të transferimit në një shoqëri tjetër administruese nga Fondi "Albsig"	-	2,395.63
Tarifa të transferimit në një shoqëri tjetër administruese nga Fondi "Smart Pension"	-	
Totali	**17,658,616.06**	**13,279,310.56**

10. Shpenzime të parapaguara

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Shpenzime të parapaguara	2,079,879.40	1,253,162.74
Totali	**2,079,879.40**	**1,253,162.74**

Shpenzimi i parapaguar përfaqëson parapagimin pranë sistemit Primera Sedam. Shuma përfaqëson ekuivalentin 21,467.50 Euro të konvertuar në lekë.

11. Shpenzime nga administrimi

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Kosto të transaksioneve	3,000.00	8,846.00
Kosto të shitjes me agjent	31,634.02	9,397.61
Shpenzime të tjera të administrimit të fondit	880,717.32	809,619.24
Totali	**915,351.34**	**827,862.85**

12. Shpenzime të tjera nga administrimi

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Tarifa e Depozitarit Fondi i Pensionit "Albsig"	635,125.26	641,429.51
Tarifa e AMF Fondi i Pensionit "Albsig"	245,592.06	89,918.09
Tarifa e Depozitarit Fondi i Pensionit "Smart Pension"	-	69,303.10
Tarifa e AMF Fondi i Pensionit "Smart Pension"	-	8,968.54
Totali	**880,717.32**	**809,619.24**

13. Shpenzime të veprimtarisë

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Shpenzime për personelin	9,952,716.80	8,081,882.00
Amortizim i aktiveve materiale afatgjata / jo-materiale afatgjata	152,067.52	162,880.02
Shpenzime të tjera të veprimtarisë	1,557,097.37	1,507,154.00
TOTALI	**11,661,881.69**	**9,751,916.02**

14. Shpenzime të tjera të veprimtarisë

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Qira	-	-
Audit	156,000.00	156,000.00
Taksa dhe tarifa vendore	57,500.00	74,500.00
Gjoba dhe dëmshpërblime	114.00	-
Shpenzime - certifikata e fiskalizimit AKSHI	-	-
Shpenzime telefonie	66,874.65	58,990.00
Mirëmbajtje sistemi Primera	963,214.72	951,536.00
Mirëmbajtje sistemi financiar	-	72,000.00
Shpenzime të tjera	313,394.00	194,128.00
TOTALI	**1,557,097.37**	**1,507,154.00**

Shpenzime të tjera përfaqëson pagesën në vlerën prej 8,600.00 Lekë për noterizim kontrate, pagesën në vlerën 278,394.00 konsulencë marketingu dhe pagesën në vlerën 26,400.00 shërbim redaktimi.

15. Të ardhura financiare

Të ardhurat financiare janë si vijon:

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Të ardhura nga interesi	810,884.45	822,957.86
Totali	**810,884.45**	**822,957.86**

Vlera prej 807,000.00 Lekë përfaqëson të ardhurën nga interesi i obligacionit 10 vjeçar; dhe vlera prej 85.72 Lekë përfaqëson të ardhurat nga interesat dhe vlera 3,798.73 janë fitimi nga këmbimet valutore.

16. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare janë si më poshtë:

	30 qershor 2026	30 qershor 2025
Shërbimet bankare	39,880.96	45,821.67
Humbja nga kursi i këmbimit	12,068.7	13,487.84
Shpenzime për interesa	11.18	-
Totali	**51,960.84**	**59,309.51**

17. Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Shpenzime personeli	1,959,245.90	827,789.50
Të pagueshme ndaj Auditit	-	288,000.00
Mirëmbajtje sistemi Primera	566,003.45	1,301,072.65
Të pagueshme ndaj Bankave Depozitare	112,631.33	132,643.82
Të pagueshme ndaj AMF	245,592.06	109,000.81
Shpenzime telefonie	13,218.67	9,600.00
Të tjera	(4,999.99)	
Totali	**2,891,691.42**	**2,668,106.78**

Vlera 4,999.99 përfaqëson një detyrim që pritet të rimbursohet nga banka.

18. Fitim Humbja

Fitim Humbja për periudhën që mbyllet më 30 qershor 2026 paraqitet si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025	30 qershor 2025
Fitimi/Humbja e mbartur	(30,212,371.54)	(35,487,943.00)	(35,487,943.00)
Fitimi/Humbja neto për periudhën	5,840,306.64	5,275,571.46	3,463,180.04
Fitim / Humbja	**(24,372,064.90)**	**(30,212,371.54)**	**(32,024,762.96)**

Përgatiti

Irfan Lami

Drejtor i Departamentit të Financës Albsig Sh.a

(funksion i deleguar)

Miratoi:

Elton Korbi

Administrator i Përgjithshëm Albsig Invest Sh.a

ALBSIG INVEST SHA
RRUGA E BARRIKADAVE, TIRANE - NUIS: L92208025J

5. Pasqyra e raportit të kapitalit
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Emërtimi	Vlera
Kapitali fillestar	15,800,000.00
Më pak ose i barabartë me	31,600,000,000.00
Asete në administrim	1,571,649,171.55
Diferenca	- 30,028,350,828.45
Rritja me 0,02 % të tejkalimit	- 6,005,670.17
Kërkesa ligjore e kapitalit	15,800,000.00

NAV 30/06/2026	
Fond Pensioni	1,258,710,278.12
Fond Investimi	307,710,476.17
Total	**1,566,420,754.29**

Asete 30/06/2026	
Fond Pensioni	1,263,556,897.38
Fond Investimi	308,092,274.17
Total	**1,571,649,171.55**

6. Pasqyra e shpenzimeve fikse
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Shpenzime Fikse (Emërtimi i zërave)*	Vlera (Lekë)
Shpenzime per Personelin	9,952,716.80
Amortizimi AAJM Software	152,067.52
Totali I shpenzimeve fikse	10,104,784.32

*Shpenzimet fikse sipas nenit 5 të rregullores nr.3, datë 31.01.2024 "Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat".

6. Pasqyra e shpenzimeve fikse
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Shpenzime Fikse (Emërtimi i zërave)*	Vlera (Lekë)
Shpenzime per Personelin	9,952,716.80
Amortizimi AAJM Software	152,067.52
Totali I shpenzimeve fikse	10,104,784.32

*Shpenzimet fikse sipas nenit 5 të rregullores nr.3, datë 31.01.2024 "Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat".

7. Pasqyra e detajimit të tarifave
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Emërtimi i fondit	Lloji i fondit	Tarifa e administrimit
Fond Pensioni "Albsig"	Fond Pensioni	12,213,946.74
Fond Pensioni "Smart Pension"	Fond Pensioni	993,806.49
Fond Investimi "Albsig Standard"	Fond Investimi	1,530,846.16

8. Pasqyra e strukturës së investimeve

8.1 Pasqyra e strukturës së aktiveve, depozita dhe llogari rrjedhëse
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Pozicioni	Referenca	Maturiteti	Vlera në momentin e depozitimit	Vlera në datën e raportimit
Depozita afatgjatë	-	-	-	-
Depozita afatshkurtër	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse	-	-	11,268,706.65	11,268,706.65
Banka Tirana - Lekë			10,302,768.33	10,302,768.33
Banka Tirana - Euro			12,144.21	12,144.21
Banka Kombetare Tregtare - Lek			953,794.11	953,794.11
Banka Kombetare Tregtare - Eur			-	-

8.2 Pasqyra e strukturës së aktiveve, titujt
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Pozicioni	ISIN	Maturiteti	Vlera Nominale	Vlera e blerjes	Vlera ne datën e raportimit
Bono thesari vendase	-	-	-	-	-
Emetime të Bankës Qendrore vendase	-	-	-	-	-
Dëftesa tregtare vendase	-	-	-	-	-
Kuota në fonde vendase	-	-	-	-	-
Tituj të tjerë vendas	-	-	-	-	-
Bono thesari të huaja	-	-	-	-	-
Emetime të Bankës Qendrore të huaj	-	-	-	-	-
Dëftesa tregtare të huaja	-	-	-	-	-
Kuota në fonde të huaja	-	-	-	-	-
Tituj të tjerë të huaj	-	-	-	-	-
TOTALI VENDASE	-	-	-	-	-
TOTALI TË HUAJA	-	-	-	-	-

8.3 Pasqyra e strukturës së aktiveve, obligacione qeveritare qendrore dhe vendore
Emri i shoqërisë administrueset: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Pozicioni	ISIN	Qellimi i mbajtjes	Shteti	Maturiteti	Vlera Nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione të qeverisë së RSH	AL022NF10Y31	Me kosto te amortizuar	Shqiperi	10 vjeçar	30,000,000.00	30,000,000.00	30,739,750.00
Obligacione bashkiake vendase	-	-	-	-	-	-	-
Obligacione të qeverive të huaja	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I OBLIGACIONEVE QEVERITARE QENDRORE DHE VENDORE					**30,000,000.00**	**30,000,000.00**	**30,739,750.00**

8.4 Pasqyra e strukturës së aktiveve, obligacione të shoqërive
Emri i shoqërisë administruese: ALBSIG INVEST SHA
Kodi i shoqërisë administruese: nr. 5, datë 22.11.2019 (pa afat)
Për periudhën: 30 qershor 2026

Pozicioni	ISIN	Qellimi i mbajtjes	Shoqëria	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione shoqërish vendase	-	-	-	-	-	-	-
Obligacione shoqërish të huaja	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE					**0**	**0**	**0**